



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

**Përmbledhje e Vërejtjeve dhe Rekomandimeve**  
**ANALIZA E SHPENZIMEVE 2020-2022**

**KOMISIONERËT PUBLIKË (63)**

**A. Lista e Programeve**

1. Veprimtaria e komisionerit publik.

**B. Komente të Përgjithshme**

1. Kërkesat buxhetore u dorëzuan brenda afatit të përcaktuar në udhëzimin nr.8, datë 28.02.2019 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022”.
2. Raportet e kërkesave buxhetore të paraqitura nga KP janë dërguar pjesërisht në përputhje me udhëzimin nr.8, datë 28.02.2019 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022”, pasi mungon formati nr.2 i plotësuar sipas tavaneve indikative të miratuara.
3. Formatet e dorëzuara janë firmosur nga Nëpunësi Autorizues.
4. Relacioni shoqërues i kërkesave është paraqitur i plotë.

**C. Analiza e Programit Buxhetor**

**Programi “Veprimtaria e komisionerit publik”**

**C.1 Formulimi i Qëllimit/Objektivave/Treguesve të Performancës**

- Formulimi i Qëllimit të Politikës së këtij programi dhe treguesi i performancës janë përcaktuar qartë.
- Është mirë-përcaktuar një objektiv dhe një tregues performance në nivel objektiv.

**C.2 Kostoja e Politikave Ekzistuese dhe Të Reja të Programit**

- Institucioni ka dërguar zyrtarisht të plotësuar formatin nr.2 sipas tavaneve që ata dëshirojnë, pra jo sipas tavaneve indikativ. Ndërsa, elektronikisht institucioni ka dërguar formatin nr.2 sipas tavaneve indikativ dhe formatin nr.3 sipas tavaneve të dëshiruara.

- Janë evidentuar dhe kostuar politikat ekzistuese. Nga krahasimi i kostimit të politikave ekzistuese me tavanin buxhetor të alokuar për këtë institucion rezulton se ka nevojë për financim shtesë për shpenzime personeli dhe tepricë në shpenzimet operative dhe kapitale.

Më konkretisht, sipas artikujve kërkesat shtesë për financim e politikave ekzistuese, për vitet 2020-2022 pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

ZËRI	Politikë ekzistuese (në mijë Lekë)		
	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Shpenzime personeli (600+601)	10,200	10,200	10,200
<b>Tepricë</b>			
Shpenzime operative (602)		-500	-1,500
Shpenzime kapitale (231)	-500	-500	-1,500
<b>Total</b>	<b>9,700</b>	<b>9,200</b>	<b>7,200</b>

- Për shpenzimet e personelit (600+601), kërkesa për shtesë fondesh rezulton si pasojë e përlllogaritjes së shtesës për vjetërsi të komisionerëve, shtesës për vështirësi, shtesat për pozicionet drejtuese dhe shtesat mbi pagë për orët jashtë orarit të punës.
- Për shpenzimet operative (602) dhe kapitale (231), referuar formateve të institucionit, rezultojnë me tepricë fondesh.

#### **D. Konkluzione**

Gjatë fazës së mëtejshme të PBA 2020-2022 KP duhet:

- Të plotësojë formatin nr.3 për kërkesat shtesë për politikat ekzistuese.
- Të plotësojë formatin nr.2 sipas taveaneve indikativ për shpenzimet e personelit dhe sipas nevojës reale (e cila është më e ulët se tavanin) për shpenzimet operative dhe kapitale.